



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II nr.991/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë**, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” sh.a., me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Malisa Invest Verdi”, me NUI ... NRB..., me seli në Podujevë Rr. “Zahir Pajaziti”, me bazë përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KPPP.nr.676/22 të dt. 18.05.2023, me datë 14.11.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit Malisa Invest Verdi, me NUI ..., NRB ..., me seli në Podujevë Rr. “Zahir Pajaziti”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale ,Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KPPP.nr.676/22 të dt. 18.05.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.676/22 të dt. 18.05.2023, ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit “Malisa Invest Verdi”, me NUI ..., NRB ..., me seli në Podujevë Rr. “Zahir Pajaziti”, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimorë P.nr.156/21 të datës 26.03.2021 të Përmbaruesit Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë debitori “Malisa Invest Verdi”, me seli në Podujevë, duke kërkuar nga Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së dytë që ta shfuqizojë vendimin e shkallës së parë.

Përgjigje në ankese nuk ka parashtruar kreditori.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Prapësimi i debitorit është i pa afatshëm.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka paraqitur propozim për përbarim me datën 26.03.2021 ndaj debitorit në bazë të dokumentit autentik Ekstraktit nga Librat e Kontabilitetit për shumën e detyrimit në vlerën prej 675,42€.

Përbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, ka lejuar përbarimin me aktvendimin P.nr.156/21 dt.26.03.2021. Ndaj aktvendim debitori ka paraqitur prapësim me datën 21.04.2021, duke theksuar se vendimi për pagese nga kreditori i përket DPH Verdi me numër fiskal 601074488 dhe numër të biznesit 71031659 me seli në Podujevë, dhe kërkon nga përbaruesi privat që ti drejtohet direkt të lartcekurit i cili ka shfrytëzuar ujin, po ashtu edhe inkasantët e kompanisë i ka dërguar faturat e biznesit, ka qenë si qiramarrës në lokalit të Malisa Invest Verdi.

Ndaj prapësimi të debitorit, kreditori me datën 23.04.2021 ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit duke kundërshtuar si të pambështetur në asnjë provë të vlefshme, më propozimin që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe propozimin për përbarim ta aprovoje në tërësi.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin KPPP.nr.676/22 dt.18.05.2023 ka hedhur poshtë si të paafatshëm prapësimin e debitorit, ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.156/21 të dt.26.03.2021 të Përbaruesit Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë.

Dhoma e Shkalles e Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 e as neni 183 të LPK, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të neni 194 të LPK.

Sipas dispozitës së neni 70 të Ligjit për Procedurën Përbarimore përcaktohet së: *“Prapësimi duhet të dorëzohet gjykatës brenda shtatë (7) ditësh pas pranimit të vendimit përbarues ose urdhrit përbarues”*, ndërsa me dispozitën e neni 73 paragrafi 3, parashihet së: *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”*.

Në këtë kontekst dhe në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjërisht ka vendosur kur e ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit, sepse nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës konstatohet se debitori aktvendimin për lejimin e përbarimit P.nr.156/21 dt.26.03.2021 e ka pranuar me datë 06.04.2021, ndërsa prapësimin ndaj këtij urdhri e ka paraqitur me datën 19.04.2021, gjë që vërtetohet nga vula e postës e vendosur në zarfin drejtuar përbaruesit, nga del se prapësimi është paraqitur pas afatit ligjor dhe si datë e fundit për paraqitjen e prapësimi ka qenë data 13.04.2021, brenda të cilit afat debitori nuk ka vepruar.

Janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore te debitorit nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë, por nuk janë konsideruar të rëndësishme për të vendosur ndryshe sepse debitori nuk ka mundur ti provoj pretendimet e tij ankimore për afatshmërinë e prapësimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të atakuar, mori parasysh pretendimet ankimore të debitorit sa i përket mënyrës së dorëzimit të propozimit për përmbarrim, respektivisht afatit për dorëimin e prapësimit. Mirëpo, Gjykata vlerëson se nuk i takon gjykatave të bëjnë vlerësime individuale të mënyrës së pranimit apo mospranimit të shkresave, respektivisht i takon secilit person juridik siç është këtu debitori, që si person juridik të kujdeset për pranimin e shkresave zyrtare dhe ruajtjen e afateve për dorëzimin e tyre. Andaj, në një gjendje të këtillë, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të ligjshme e ka hedh si të pasafatshëm prapësimin e palës duke u nisur nga fakti se koha e pranimit të propozimit për përmbarrim në adresën e debitorit si person juridik.

Kompetenca e Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II nr.991/23, me datë 14.11.2023**

**Gjyqtari**  
**Dren Rogova**